



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Janar 2022

Nr: 5

V E N D I M

P Ë R

**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE  
SEKRETARËT E KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR PËR  
ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKITË  
SHKODËR, DIBËR, DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJE  
TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13 438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 29, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Referuar nenit 19, pika 1, shkronja “n”, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njih shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetenca për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarë të KZAZ-ve.

Kodi Zgjedhor, neni 29, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, përcakton se anëtarët e KZAZ-së, emërohen nga KQZ, sipas procedurës si më poshtë:



Data: 24 Janar 2022

Nr. 5

“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022”

dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet barazpeshimi politik, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në barazpeshimin politik shumicë-opozitë. Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare.

Bazuar në përcaktimet e nenit 29, pika 4, të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendore në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare.

Referuar nenit 183, pika 8, të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, e drejta e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë – pakicë të Kuvendit të Shqipërisë në çeljen e tij menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.

Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 259/1 Prot., datë 24.01.2022, arsyetohet si vijon:

- Zgjedhjet e pjesshme vendore të vitit 2022, do të zhvillohen në 6 bashki të vendit vetëm për vakancat e krijuara për kryetarët e bashkive. Mandatet të cilat për arsye që ligji përcakton kanë mbetur vakant dhe janë ndërprerë, do të vijojnë të ushtrohen nga kryetarët e rinj që do të zgjidhen në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022 për periudhën e mbetur deri në vitin 2023.
- Neni 29 i Kodit Zgjedhor, përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve. Nga ana tjetër, vetë legjislatori ka përcaktuar një dispozitë kalimtare, nenin 183, pika 3, të Kodit Zgjedhor, e cila është e aplikueshme në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore pas hyrjen në fuqi të amendimeve të vitit 2020. Pikërisht këtë dispozitë zbatoi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, kur caktoi partitë të cilat gëzonin të drejtën për të propozuar anëtarët e KZAZ-ve.
- Në zgjedhjet e pjesshme të vitit 2022, zgjedhësit do të votojnë për kandidatët e bashkive të cilët do të ushtrojnë detyrën e cila është vazhdim i mandateve të dala nga zgjedhjet e vitit 2019 dhe që do të zgjasin deri në vitin 2023, kur do të zhvillohen zgjedhjet e para të pushtetit vendor pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të Kodit Zgjedhor.

- Kushtetuta në nenin 109, përcakton se, si organet përfaqësuese të njëjësive bazë të qeverisjes vendore, ashtu dhe organi ekzekutiv i bashkisë, i cili është Kryetari, zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

Nga sa më lart, dispozita tranzitore është e paaplikueshme për zgjedhjet e pjesshme të vitit 2022, pasi këto zgjedhje konsiderohen vazhdim i një mandati të ndërprerë dhe në përfundim të tyre, kryetarët e rinj nuk do të përfitojnë një mandat 4-vjeçar siç përcakton neni 109 i Kushtetutës.

Në përcaktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet e pjesshme vendore të vitit 2022, do të zbatohet e njëjta formulë që është aplikuar në vitin 2019, duke u bazuar në vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021”, në vendimin nr. 965, datë 10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore 2015”, dhe në shkresën e Kuvendit të Shqipërisë nr. 259/1 Prot., datë 24.01.2022. Sipas këtyre vendimeve renditja e partive për efekt të zbatimit të procedurës për përbërjen e KZAZ-ve për zgjedhjet vendore 2022, është si më poshtë:

#### Shumica parlamentare

##### 1. Partia Socialiste e Shqipërisë:

74 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

402.709 vota të fituara për këshillat vendorë, zgjedhjet 2015

#### Pakica parlamentare

##### 1. Partia Demokratike e Shqipërisë “Aleanca për Ndryshim”:

59 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

317.620 vota të fituara në shkallë kombëtare për këshillat vendorë, zgjedhjet 2015

##### 2. Lëvizja Socialiste për Integrim:

4 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

259.934 vota të fituara në shkallë kombëtare për këshillat vendorë, zgjedhjet 2015

##### 3. Partia Socialdemokrate:

3 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

22.320 vota të fituara në shkallë kombëtare për këshillat vendorë, zgjedhjet 2015

Partia Socialiste e Shqipërisë, do të paraqesë tre kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve, dy kandidatura si parti e parë e shumicës parlamentare dhe kandidatura e tretë për të realizuar barazpeshimin politik shumicë - opozitë në përbërjen e KZAZ-ve.



Partia e parë dhe e dytë e opozitës parlamentare të cilat do të propozojnë anëtarë të KZAZ-ve, janë Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste për Integrim.

Sekretari i KZAZ-së do të propozohet:

- a) Nga partia Socialiste e Shqipërisë në KZAZ-të ku Partia Socialiste ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së;
- b) Nga Partia Demokratike në KZAZ-të, ku Partia Demokratike ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së.

Anëtari i shtatë i KZAZ-së, do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, parti kryesore e shumicës parlamentare dhe në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Demokratike e Shqipërisë, parti kryesore e opozitës parlamentare, në përputhje me përcaktimet e nenit 29, pika 1, shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 29, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

### **V E N D O S :**

2. Të caktojë partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), që do të ngrihen dhe funksionojnë për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, si më poshtë:
  - a) Tre anëtarë propozohen nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
  - b) Dy anëtarë propozohen nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
  - c) Një anëtar propozohet nga Lëvizja Socialiste për Integrim;
3. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve do të propozohet në përputhje me rezultatet e shortit të hedhur në KQZ, ndërmjet Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë Demokratike të Shqipërisë.
4. Sekretari i KZAZ-së do të propozohet:
  - a) Nga partia Socialiste e Shqipërisë në KZAZ-të ku Partia Socialiste ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së;
  - b) Nga Partia Demokratike në KZAZ-të, ku Partia Demokratike ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së;



5. Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë të KZAZ-ve jo më vonë se data 25 Janar 2022.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzetë e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 24 Janar 2022

Nr. 5

“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 Mars 2022”